



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 150, Datë 08.07.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SH.A. PËR
MIRATIMIN “E NJË UDHËZUESI MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 20 gërmat “a”, 23 pika 1 gërma “b”, 30 pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.07.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1776/1 prot., datë 03.07.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Rregullores së komisionit (BE) 2017/1485 e 2 Gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 2907 prot., datë 26.05.2025, protokolluar në ERE me nr. 1776 prot., datë 28.05.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, datë 02.08.2017, mbi Udhëzuesin për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.
- Në këtë kërkesë, OST sh.a. informon se Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në mbledhjen e datës 14–15 dhjetor 2022, ka miratuar Vendimin nr. 2022/03/MC-EnC, përmes të cilit kjo rregullore është përfshirë në *acquis communautaire* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër.
- Rregullorja (BE) 2017/1485, e njohur si Udhëzuesi për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, vendos një kornizë të harmonizuar për operimin e koordinuar, të sigurt dhe efikas të sistemeve elektroenergjetike në zonat sinkrone, duke përcaktuar rregulla të detajuara për OST-të dhe strukturat rajonale të koordinimit të sigurisë. Ajo synon të garantojë sigurinë operationale, stabilitetin e frekuencës dhe funksionimin në kohë reale të rrjeteve të ndërlidhura.
- Rregullorja përcakton rregulla të qarta dhe të detajuara për mënyrën se si Operatorët e Sistemeve të Transmetimit (OST-të) duhet të planifikojnë, të koordinojnë në kohë reale operimin e rrjetit dhe të shkëmbejnë të dhëna me njëri-tjetrin, me qëllim ruajtjen e stabilitetit

të rrjetit, mbajtjen e cilësisë së frekuencës, menaxhimin e devijimeve dhe reagimin e përbashkët ndaj kontigjencave.

- Gjithashtu, kjo rregullore standardizon qasjen ndaj operimit të sistemit në nivel ndërkombëtar, duke e bërë të mundur sinkronizimin e proceseve operacionale, krijimin e kushteve për kontrollin fuqi-frekuencë dhe përfshirjen e qendrave të koordinimit rajonal në mbështetje të OST-ve. Ajo siguron që rrjetet kombëtare të operojnë si pjesë e një sistemi të vetëm të ndërlidhur evropian, duke ruajtur integritetin dhe sigurinë e tij në çdo moment.
- Në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe nevojën për harmonizim me rregullat e BE-së, ERE vlerëson të nevojshme nisjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës dhe organizimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve me palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe aktorët e tregut të energjisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Udhëzuesit për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike” miratuar me Rregulloren e komisionit (BE) 2017/1485, datë 02 gusht 2017.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît AHMETI